

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-240/11

Prishtinë, 3 tetor 2012

Në çështjen juridike të:

Ž. T.

Adresa . . .

Identifikuesi . . .

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

N. J.,

Adresa . . .

Identifikuesi . . .

Emri . . .

Pala përgjegjëse në kërkesë- pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/108/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat KPA34698, KPA34699, KPA347000 , KPA34701 dhe KPA34702), të datës 13 maj 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 3 tetor 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga Ž. T. të datës 12 dhjetor 2011, të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-240/11, GSK-KPA-A-241/11, GSK-KPA-A-242/11, GSK-KPA-A-243/11, GSK-KPA-A-244/11, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-240/11.
- 2- Refuzohen si të pabazuara ankesat e Ž. T. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/108/2011, i datës 13 maj 2011.
- 3- Vërtetohet vendimi i të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/108/2011, i datës 13 maj 2011, për sa i përket lëndëve të regjistruara pranë AKP-ës nën numrat KPA34698, KPA34699, KPA34700, KPA34701 dhe KPA34702.
- 4- Obligohet pala ankuese që t'i paguaj shpenzimet e procedurës shumë prej € 350 (treqind e pesëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 30 nëntor 2007, Ž. T., në Agjensinë Kosovare të Pronës ka paraqitur pesë kërkesa për pronën private në emër të axhës së tij tashmë të vdekur Lj. T. u, i cili sipas tij edhe është titullar i të drejtës pronësore të paluajtshmërive si tokë bujqësore, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave kadastrale të tokës bujqësore. Kërkesat e sipërcekura i referohen lëndëve të regjistruara në këtë gjykatë: GSK-KPA-A-240/11, GSK-KPA-A-241/11, GSK-KPA-A-242/11, GSK-KPA-A-243/11 dhe GSK-KPA-A-244/11. Me këto kërkesa ai pretendon se posedimi është humbur me 16 qershor 1999 dhe se të drejtat pronësore në ato paluajtshmeri nuk mund të shfrytëzohen për shkak të rrethanave drejtpërdrejtë të ndërlidhura ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në periudhën ndërmjet 27 shkurt 1998 deri me 20 qershor 1999.

Në Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronësisë të Zyrës Kadastrale në Fushë Kosovë UL-7251407100006, të datës 27 qershor 2008, J. N. e cila është përgjigj në kërkesë, është regjistruar se është pronare e këtyre ngastrave kadastrale:

Numri i lëndës në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe numri i lëndës së AKP-ës	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-240/11 (KPA34698)	Nr. 397, në vendin e quajtur “Dole Bresjaka”: arë e klasës së 2-të, në sipërfaqe prej 0.76.13 ha, Zona Kadstrale Ugljar, Komuna e Fushë Kosovës.
GSK-KPA-241/11 (KPA34699)	Nr. 467/2, në vendin e quajtur “Donja Livađa”, livadh, e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 0.15.39 ha, Zona Kadstrale Ugljar, Komuna e Fushë Kosovës.
GSK-KPA-242/11 (KPA34700)	Nr. 468, në vendin e quajtur “Donja Livađa”, arë, e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 0.12.81 ha, Zona Kadstrale Ugljar, Komuna e Fushë Kosovës.
GSK-KPA-243/11 (KPA34701)	Nr. 499, në vendin e quajtur “Livade Smonica”, arë, e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 0.35.94 ha, Zona Kadstrale Ugljar, Komuna e Fushë Kosovës.
GSK-KPA-244/11 (KPA34702)	Nr. 789, në vendin e quajtur “Kecmanovo”, arë, e klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 0.73.98 ha, Zona Kadstrale Ugljar, Komuna e Fushë Kosovës.

Për t'i mbështetur kërkesat e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP këto dokumente-prova:

- Ekstraktin nga Libri Amë i të Vdekurve, të lëshuar nga Komuna e Fushë Kosovës, Nr. 05 i datës 04 nëntor 1991, me të cilën konstatohet se Lj. T. ka vdekur në fshatin Ugljare të Fushë Kosovës me 9 shtator 1991.
- Fletën Poseduese të lëshuar nga Drejtoria Gjeodete Komunale në Prishtinë me datë 18 tetor 1988;
- Letënjoftimin në emër të Ž. T. të datës 22 shkurt 2000.

N. J. në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë i ka kontestuar kërkesat e paraqitësit Ž. T. duke theksuar se ajo është titullar i të drejtës së pronësisë së pronave të kërkuara. Bashkangjitur përgjegjës në kërkesë ajo i ka dorëzuar edhe këto prova:

-Kontrata e Cedimit dhe e Pjesëtimit të Pronës VR. nr. 3315/10, të datës 13 Maj 2010;

-Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë T.nr. 7/92, të datës 16 Janar 1992, me të cilin J. N. – palë përgjegjëse në kërkesë - është shpallur trashëgimtare e masës trashëgimore të të ndjerit T. Lj. e që është objekt i kërkesës;

-Fletën Poseduese Nr. 285 të Shërbimit për Kadastër të Paluajtshmërisë Nr. 952-01-1/97, të datës 21 gusht 1997;

-Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronësisë të Zyrës Kadastrale në Fushë Kosovë UL-7251407100006, të datës 27 qershor 2008;

-Aktvendim i Zyrës Kadastrale të Fushë Kosovës Nr. 527/2008, e datës 26 qershor 2008.

Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës, në procesin e verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar ka verifikuar pozitivisht Fletën Poseduese Nr. 285 të datës 21 gusht 1997, me të cilën konstatohet se ngastrat e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës janë në emër të palës përgjegjëse si titullare e të drejtës pronësore. Fleta Poseduese është në përputhje me Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronësisë të Zyrës Kadastrale në Fushë Kosovë UL-7251407100006, të datës 27 qershor 2008. Ndërkaq, në arkiven e Gjykatës Komunale nuk është gjetur Aktgjykimi C.nr.1296/94, i datës 31 mars 1998 dhe Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë T.nr.7/92, i datës 16 janar 1992. Megjithatë, Çertifikata mbi të Drejtat e Pronësisë është gjetur ex officio nga zyrtari për verifikim i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-ës, të datës 11 tetor 2010, e cila paraqet situatën aktuale të parcelave të kërkuara dhe që konstaton se pala përgjegjëse në kërkesë është pronare e pronave kontestuese.

Në vitin 2008 dhe 2010, AKP-ja përmes Ekipit të Njoftimit, ka dalur në vendin ku supozoheshin pronat e kërkuara dhe ka vendosur lajmërimet përkatëse në ngastrat kadastrale. Më vonë në procedurë, N. J., në cilësinë e palës përgjegjëse është paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive duke i kontestuar kërkesat e paraqitura dhe duke paraqitur edhe prova përkatëse.

Duke i paraqitur provat në AKP, pala përgjegjëse thekson se është titullare e të drejtës së pronësisë në palujtshmëritë e kërkuara nga Ž. T. Ajo më tej thekson se paraqitësi i kërkesës nuk është pronar i këtyre palujtshmërive dhe se kërkesën ai e ka paraqitur pa qenë i autorizuar për një veprim të tillë.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/108/2011, i datës 13 maj 2011, ka vendosur që kërkesat e paraqitësit të kërkesave Ž. T. të hedhen si të papranueshme me arsyetimin se ai nuk kishte paraqitur autorizim nga anëtari i bashkësisë familjare – xhaxhait të tij - për të pasur zotësinë e veprimit për të depozituar kërkesën në emër të titullarit të së drejtës pronësore.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 2 dhjetor 2011.

Me 12 dhjetor 2011, Ž. T. (tani e tutje: ankuesi) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së, mbi bazën e vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, duke i kërkuar gjykatës që të vendoset pozitivisht për ankesën e tij. Më tutje, në ankesën e tij thekson se me vdekjen e axhës i tij Lj. T. dhe të bashkëshortes së tij D. T., trashëgimtar në masën trashëgimore është dashur të jenë vëllezërit e tij T., D. dhe motra L. T. Ndërkaq, motra e axhës N. T., që është palë përgjegjëse në kërkesë, ka bërë transacionin mashtrues dhe në bazë të aktvendimit të trashigimisë T.nr.7/92, të datës 16 janar 1992, pa dijeninë e

anëtarëve të tjerë të familjes është shpallur trashëgimtare e vetme dhe në bazë të këtij aktvendimi në zyrën kadastrale është bërë edhe pronare.

Babai i paraqitësit të kërkesës T. T. ka pranuar aktgjykimin C.nr.1296/94, të datës 7 nëntor 1998, me të cilin është konstatuar që N. T., nuk ka qenë vajza e Lj. T. Në fund paraqitësi i kërkesës thekson se ata kanë gabuar që me kohë nuk kanë përgatitur dhe zbatuar procedurën trashëgimore dhe ti zgjidhin marrëdhënjet pronësoro brenda familjes por që shpreson gjë do ta bëjë shumë shpejtë.

Pala përgjegjëse në ankesë N. J. ka paraqitur përgjegje në ankesën e ankuesit me datë 16 janar 2012, duke e kontestuar ankesën e tij, me ç'rast për shkak të mungesës së autorizimit dhe të drejtës së pronësisë së ankuesit ka propozuar që ankesa të hedhet poshtë. Mbi bazën e aktvendimit të trashëgimisë T.nr.7/92 të datës 16 janar 1992 dhe Fletës Poseduese Nr. 285 të Zonës Kadastrale Ugljare, ajo është pronare e palujtshmërive të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës dhe se kërkesa e paraqitësit të saj nuk ka të bëjë me rrethanat drejtëpërsëdrejti të ndërlidhura apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIKut 2006/50 AKP-ja nuk ka qen kompetente për të vendosur për këtë çështje juridike.

Për shkak se Ž. T. nuk ka qenë pronar i pronës së kërkuar dhe se ai nuk e ka humbur të drejtën në të për shkak të rrethanave drejtëpërdrejtë të lidhur ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur, kërkesa e tij duhet të hedhet si e papranueshme për shkak të mungesës së jurusidiksionit duke e hedhur gjithashtu edhe ankesën.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Palujtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin

mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 5 (pesë) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

Ankesat e paraqitura nga Z. T. të datës 12 dhjetor 2011, të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-240/11 deri GSK-KPA-A-244/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numër GSK-KPA-A-240/11.

Pranueshmëria e ankesave:

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.

Në rastin konkret vendimet e KKPK-ës i janë dorëzuar ankuesit me datë 02 dhjetor 2011, ndërsa ankesat nga ana e tij janë parashtruar me datë 12 dhjetor 2011, e që është më pak se 30 ditë nga dita e pranimin të njoftimit mbi vendimet e KKPK-ës.

Pala përgjegjëse në kërkesë/pala përgjegjëse në ankesë N. J., vendimin ankimor e ka pranuar me datë 10 dhjetor 2011, ankesën e ka pranuar me datë 16 dhjetor 2011 dhe përgjegjjet në ankesë i ka paraqitur me 30 dhjetor 2011.

Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor; sidoqoftë janë të pabazuara.

Meritat:

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se se në bazë të dokumentacionit të siguruar nga paraqitësi i kërkesave pretendimeve të theksuara në ankesë, provave të siguruara nga pala përgjegjëse në kërkesë/pala përgjegjëse në ankesë rezulton se vendimi ankimor është marr me vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural, kur ka vendosur në vendimin ankimor që kërkesat e regjistruara në AKP nr. 34698, 34699, 34700, 34701 dhe 34702 duhet të hedhen poshtë për shkak se paraqitësi i kërkesave – ankesuesi nuk ka mundur të paraqesë autorizim juridikisht të vlefshëm për të pasur zotësi juridike të vlefshme për të paraqitur këto kërkesa përkatësisht ankesat në emër të titullarit të së drejtës pronësore, të parashikuar sipas dispozitave të nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e ndryshuar me me Ligjin /L-079. Me këtë dispozitë ligjore shprehimisht parashikohet që në procedurën para Komisionit, në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të deponohet nga anëtar i ngushtë i familjes të atij personi. Paraqitësi i kërkesës mund të përfaqësohet nga një person fizik i autorizuar me autorizim të vlefshëm dhe të proceduar si duhet.

Sidoqoftë, paraqitësi i kërkesës nuk e ka këtë autorizim. Paraqitësi i kërkesës, si nip i të ndjerit Lj. T. nuk është anëtar i familjes së ngushtë i këtij ish bartësi të së drejtës pronësore. Nga kjo mund të konkludohet se paraqitësi i kërkesës duhet të ofrojë AKP-ës dhe Gjykatës autorizimin të dhënë nga personat të cilët tani janë pronarë ose duhet që vet të vërtetojë se është pronar i pronës. Ankuesi nuk i ka shfrytëzuar asnjërën nga këto mundësi. Sidoqoftë, ai i ka ofruar Gjykatës vendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës No. 1296/94 të datës 31 Mars 1998 – me të cilin është vendosur që N. J. T. nuk është trashëgimtare e Lj. T. Ky vendim, gjithashtu nuk paraqet provë se paraqitësi i kërkesës vetë është përfaqësues i pronarëve të pronës ose vet pronarit të pronar. Së pari, Gjykata vëren se ky vendim nuk është i vërtetuar si i plotëfuqishëm por që mund të ankimohet. Së dyti, vendimi nuk thotë asgjë për pronësinë rreth pronës së kontestueshme.

Më tutje, Gjykata gjen se lënda nuk është mbrenda jurisdiksionit sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Gjykata Supreme ka jurisdikcion në rastet kur të drejtat pronësore nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që lidhen direkt ose që janë rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur mbrenda periudhës kohore midis 27 shkurt dhe qershor 1999. Në rastin në fjaë, objekt shqyrtimi i kërkesës së paraqitur me sa duket ka të bëjë me një konflikt të vjetër midis ankuesit dhe palës përgjegjëse në ankesë për sa i përket trashëgimisë së Lj. T., i cili si i tillë kishte ekzistuar para konfliktit të armatosur dhe se nuk ka të bëjë asgjë më këtë konflikt.

Mbi bazën e gjithë kësaj, ankesat duhet të refuzohen dhe vendimi i KKPK-ës për sa i përket pronës objekt kontesti të vërtetohet.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10, 21, 10,12 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në € 50,000: € 300 (€ 50 + 0,5% e € 50,000).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it